



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.11, datë 19.10.2022

**PËR**  
**PËR DEKLARIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE**  
**TË 24 APLIKIMEVE PËR LEJE NDËRTIMI**

Në mbështetje të nenit 94, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 27<sup>1</sup> dhe 28, pika 1, 39, 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, 19 dhe 25, të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit pasi mori në shqyrtim propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

**VENDOSI:**

1. Të deklarojë përfundimin e procedurave administrative për 24 aplikime, të paraqitura për miratim Leje Ndërtimi pranë KKT-së, të cilat nuk janë pajisur me Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, pasi janë braktisur nga aplikuesit, duke mos shprehur interes për vazhdimin e tyre, nëpërmjet mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe dokumentacionit përkatës sipas legjislacionit në fuqi.
2. Aplikimet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të cilët i përkasin periudhës kohore 2015-2018, evidentohen në dy listat e poshtëshënuara, të cilat bashkëngjiten dhe bëhen pjesë e këtij vendimi:
  - a) “Lista 1” ku pasqyrohen aplikimet e deleguara në rrugë shkresore nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT);
  - b) “Lista 2”, me aplikime të paraqitura pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).
3. Sekretariati Teknik i KKT-së të marrë masat për zhvillimin e procedurës së refuzimit të aplikimeve të Listave 1 dhe 2, sipas rastit, në rrugë shkresore, ose nëpërmjet sistemit e-leje.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
EDI RAMA






MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETARI KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**



Lista Nr. 1

**Vendimi Nr. 3, datë 07.03.2014** “Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për objektin: “Ndërtimin e qendrës së prodhimit të industrisë farmaceutike, Komuna Bubq, Qarku Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Elira-Gent Al Pharma” sh.p.k.

2. **Vendimi Nr. 3, datë 07.03.2014** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: " HEC Bisak ", me vendndodhje në burimet e Bardhgjanës, Komuna Fan, Qarku Lezhë”, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “ Bardhgjana” sh.p.k.
3. **Vendimi Nr. 6, datë 05.05.2015** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “HEC Gavran dhe Gavran 1”, në përroin e Fragovishtës Komuna Stavraj, Qarku Elbasan”, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare "Gavran Energy" sh.p.k.
4. **Vendimi Nr. 9, datë 09.09.2015** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: Ndërtimi i hidrocentraleve “Gjadër 1/1”, “Gjadër 1/2”, “Gjadër 2”, “Gjadër 3”, “Gjadër 4”, “Gjadër 6”, mbi lumin Gjadër me shtrirje në territorin e bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Lezhë dhe Pukë., “S.P.E.Gjadër” sh.p.k

Lista Nr. 2

1. **Vendimi Nr. 2, datë 29.10.2015** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit “Ndërtimin e depozitave bregdetare me kapacitet  $2 \times 10.000 \text{ m}^3$ , në zonën energjetike dhe industrial të Porto-Romanos, Durrës”, me zhvillues shoqëria “ISC Petroleum Company” sh.a.
2. **Vendimi Nr. 3, datë 29.10.2015** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin e një impjanti të depozitimit dhe shpërndarjes e tregëtimit të nënprodukteve të naftës, në zonën energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës”, me zhvillues shoqëria “NASAEL” sh.a.
3. **Vendimi Nr. 4, datë 30.12.2015** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Fabrikë Pasurimi Kromi”, në Ternovë, Njësia Administrative Zerqan, Bashkia Bulqizë, me propozim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, me zhvillues shoqëria “Zen Tol” sh.p.k.
4. **Vendimi Nr. 2, datë 07.03.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks Turistik “Prestige Holiday Resort”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Erjoni” sh.p.k.
5. **Vendimi Nr. 4, datë 07.04.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Impiant I pasurimit të mineralit krom” në Myc-Mamëz, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Burimi-XH” sh.p.k.
6. **Vendimi Nr. 13, datë 07.06.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë kapaciteti të depozitave ekzistuese dhe ndërtimi i Depozitave Bregdetare të reja të karburanteve në Porto Romano”, me vendndodhje në zonën energjetike-industriale Porto Romano, Katundi i Ri, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Porto Romano Oil” sh.a.
7. **Vendimi Nr. 06, datë 08.07.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Sheshi I Pusit AT76/a dhe rruga lidhëse, në Bllokun “F”, Cakran, Bashkia Fier”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Bankers Petroleum Albania” L.t.d.
8. **Vendimi Nr. 07, datë 08.07.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Sheshi i Pusit F53/a dhe rruga lidhëse, në Bllokun “F” Cakran, Bashkia Fier”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Bankers Petroleum Albania” L.t.d.
9. **Vendimi Nr. 03, datë 28.07.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Centrali Elektrik Fotovoltaik “Malësia Solar 1”, me vendndodhje në Lohje të Poshtme, Bashkia Malësia e Madhe”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Malësia Solar 1” sh.p.k.
10. **Vendimi Nr. 04, datë 28.07.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Centrali Elektrik Fotovoltaik “Malësia Solar 2”, me vendndodhje në Lohje të Poshtme, Bashkia Malësia e Madhe”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Malësia Solar 2” sh.p.k.

11. **Vendimi Nr. 05, datë 28.07.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Centrali Elektrik Fotovoltaik “Malësia Solar 3”, me vendndodhje në Lohje të Poshtme, Bashkia Malësia e Madhe”, me subject zhvillues shoqërinë “Malësia Solar 3” sh.p.k.
12. **Vendimi Nr. 13, datë 28.07.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Qendër Tregtare “Vllaznia”, Bashkia Shkodër”, me subject zhvillues shoqërinë “Arbi Group” sh.p.k.
13. **Vendimi Nr. 02, datë 11.10.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rrugë zëvendësuese M03 – Bregu Verior I rezervuarit të Moglicës”, me subject zhvillues shoqërinë “Devoll Hydropoëer” sh.a
14. **Vendimi Nr. 08, datë 11.10.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleksi Blegtorial “Butrinti Ferm”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë”, me subject zhvillues shoqërinë “Butrinti Ferm” sh.p.k.
15. **Vendimi Nr. 07, datë 23.11.2016** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kampus Universitar “Universiteti Epitech”, Bashkia Vorë”, me subject zhvillues shoqërinë “Academy Plus” sh.p.k.
16. **Vendimi Nr. 05, datë 12.04.2017** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rafineri Bitumi”, me vendndodhje në Parkun Energjetik dhe Industrial, Porto Romano, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Albitumen” sh.a.
17. **Vendimi Nr. 03, datë 02.02.2018** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i hidrocentraleve “Zaje”, “Tujan”, “Xhaferraj”, “Kollovoz” dhe “Novosejë”, në rrjedhën e përroit të Rekës dhe të Shishtavecit, Bashkia Kukës, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “Reka Energy” sh.p.k.
18. **Vendimi Nr. 08, datë 26.07.2018** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Nënstacion 110/35/20 kV Arras dhe linjë elektrike 110 kV”, Bashkia Dibër”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hydro Seta” sh.p.k.
19. **Vendimi Nr. 7, datë 03.10.2018** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Pikë me interes religjioz dhe panoramik në Sari-Salltik (teleferik) dhe ndërtimi i stacioneve dhe objekte shërbimi 1 kat, me zhvillues shoqërinë “Urbatrans” sh.p.k”.
20. **Vendimi Nr. 7, datë 03.10.2018** “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Depozita Bregdetare të Karburanteve, shtesë kapaciteti ( $V= 84\ 354\ m^3$ ), me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës”, me zhvillues shoqërinë “B-Jera” sh.a.